

Përmbledhje e projektit

“Parandalimi dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm në burgje dhe në Shërbimin e Provës (Faza I)”

Gjatë viteve të fundit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka mbështetur Shqipërinë në krijimin e një baze solide drejt ndërhyrjeve efektive dhe të bazuara në të drejtat e njeriut për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çojnë në terrorizëm (P/CVERLT). Përgjatë punës në këtë drejtim, Prezenca ka ofruar asistencë domethënëse për Qendrën Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) dhe institucione të tjera qeveritare në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Mbështetja e Prezencës për sistemin e burgjeve dhe Shërbimin e Provës përputhet me qëndrimin e OSBE-së, si dhe me faktin se këto institucione luajnë, në nivel ndërkombëtar, një rol jetësor në menaxhimin e rreziqeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm (VERLT).

Si pjesë e veprimeve konkrete, në nëntor 2017, Prezenca nënshkroi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Koordinatorin Kombëtar kundër Ekstremizmit të Dhunshëm një Memorandum Mirëkuptimi për zbatimin e projektit

jashtëbuxhetor “Parandalimi dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm në burgje dhe në Shërbimin e Provës (Faza I)”, të mbështetur financiarisht nga Qeveria e Austrisë, Qeveria e Suedisë, Qeveria e Republikës Federale Gjermane dhe Qeveria e Republikës së Italisë. Projekti u zbatua në partneritet të ngushtë me Qendrën Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Gjatë tri viteve, kontributi i Prezencës në zbutjen e rreziqeve të VERLT në Shqipëri ka qenë i rëndësishëm në katër drejtime kryesore: **kryerjen e një vlerësimi të nevojave** për situatën në burgje dhe shërbimin e provës; zhvillimin e një moduli bazë trajnimi mbi fenomenin e VERLT dhe **ngritjen e kapaciteteve** për stafin e burgut dhe të Shërbimit të Provës; **forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe rritjen e ndërgjegjësimit midis palëve të interesuara** mbi VERLT dhe ndërhyrjet përkatëse të bazuara në të drejtat e njeriut në sistemin penitenciar në Shqipëri.

Rezultati I

Prezenca, në bashkëpunim me Institutin Ndërrajonal të Kombeve të Bashkuara për Kërkimet në Fushën e Drejtësisë dhe Krimin (UNICRI), përgatiti një **Raport të Vlerësimit të Nevojave: Analiza e aftësive të Republikës së Shqipërisë për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm në burgje dhe në Shërbimin e Provës në Shqipëri**, për të ndihmuar në politikën e ardhshme dhe vendimet e lidhura me ngritjen e kapaciteteve dhe menaxhimin në këtë fushë.

Raporti i Vlerësimit të Nevojave shërben si burim fillestar për autoritetet shtetërore dhe organizatat në terren për të punuar me programet e shkëputjes në burgje dhe në Shërbimin e Provës dhe shërben si bazë për planifikimin strategjik. Ky raport shërben si një hartë treguese për programin e parë kombëtar të rehabilitimit dhe riintegrimin për të dënuarit, pjesë e Planit të Veprimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

P/CVERLT në burgje dhe Shërbimin e Provës në Shqipëri ishte në fokus të një konference, të organizuar në prill 2017, nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Qendrën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm si partnerë kyç të Prezencës në trajtimin e një çështjeje të tillë të rëndësishme. Mbi 70 pjesëmarrës në Konferencë u informuan mbi raportin bazë mbi situatën aktuale të VERLT në burgje dhe shërbim prove që shërbeu si bazë për vlerësimin e nevojave për këtë fenomen, si dhe për Manualin Bazë të Trajnimit për stafin e burgjeve dhe të Shërbimit të Provës.



Foto nga konferenca “P/CVERLT në burgje dhe në Shërbimin e Provës në Shqipëri”, Tiranë, prill 2018

Bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Vlerësimit të Nevojave, Prezenca hartoi një **studim kërkimor mbi efektet e grupeve ekstremiste të dhunshme në**

burgje, faktorët shtytës dhe tërheqës dhe mënyrën se si menaxhimi dhe procedurat e tanishme mund të zbutin këto efekte. Kërkimi u krye gjatë periudhës qershor-korrik 2019 në shtatë IEVP ku kishte të paraburgosur / të dënuar për vepra lidhur me terrorizmin.

Rezultati II

Prezenca hartoi Manualin Bazë të Trajnimit dhe zhvilloi trajnime mbi çështjet e lidhura me P/CVERLT për stafin e burgjeve dhe Shërbimit të Provës. Me qëllimin për të rishikuar dhe miratuar strukturën dhe formatin e Manualit Bazë të Trajnimit, Prezenca ngriti dhe drejtoi një Grup Pune, të përbërë nga institucione kombëtare dhe ekspertë të Prezencës. Manuali i Trajnimit përqendrohet në konceptet dhe praktikën e mira në dispozicion, dhe përfshin aspekte të ndryshme të trajtimit të të miturve dhe grave, siç përshkruhet në kornizën normative të OSBE-së dhe botimet përkatëse.

Prezenca ndihmoi drejtpërdrejt stafin e burgjeve dhe të Shërbimit të Provës në ngritjen e kapaciteteve për trajtimin efektiv të rreziqeve të VERLT, veçanërisht në këndvështrimin e respektimit të të drejtave të njeriut. Rreth 250 punonjës të vijës së parë në burgje dhe Shërbimin e Provës u trajnuan mbi konceptin e VERLT dhe sfidat e përfshira në identifikimin e faktorëve shtytës dhe tërheqës që mund t'i çojnë individët drejt radikalizmit dhe terrorizmit. Pjesëmarrësit u pajisën me njohuri rreth sfidave kryesore në adresimin e rreziqeve të VERLT në kontekstin e burgjeve dhe në Shërbimin e Provës, mbi të drejtat e njeriut që mund të preken dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre për të siguruar parandalim efektiv të terrorizmit dhe VERLT.



Foto nga sesionet e trajnimeve të mbajtura me stafin e burgjeve dhe të Shërbimit të Provës në Fier, Tiranë dhe Lezhë, dhjetor 2017 - nëntor 2018

Në korrik 2019, u zhvilluan **dy seanca trajnimi mbi Protokollin e Procedurave të Sigurisë për P/CVE** me stafin e IEVP-ve të Peqinit dhe Fushë-Krujës. Rreth 55 punonjës të vijës së parë, përfshirë punonjës socialë, punonjës sigurie dhe staf edukimi u trajnuan për aplikimin e këtij protokollin, ku u diskutuan çështje të tilla si siguria dinamike, parimet ndërkombëtare dhe standardet për P/CVE dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësve të sistemit të burgjeve.

Në tetor 2019, Prezenca ngriti dhe drejtoi një Grup Pune për zhvillimin e një **Instrumenti të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për Ekstremizëm të Dhunshëm**, me përfaqësues të QKEDH-së, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Prezencës. Ky Instrument do të përdoret nga stafi i burgjeve dhe Shërbimit të Provës për çdo ndërhyrje në të ardhmen në lidhje me temën, si ndërtimi i kapaciteteve në menaxhimin e të burgosurve të dënuar për vepra penale lidhur me terrorizmin dhe identifikimin dhe adresimin e rreziqeve VERLT, ashtu edhe programet e trajtimit për rehabilitim dhe riintegrim, përfshirë programet individuale të trajtimit për këta të dënuar.

Rezultati III

Duke theksuar rolin drejtues në fushën e P/CVERLT në kontekstin e burgjeve dhe Shërbimit të Provës, **Prezenca mbështeti një numër veprimtarish rajonale, duke kontribuar në nxitjen e një përpjekjeje të koordinuar ndërkombëtare për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë efektive.** Në këtë kuadër, Prezenca në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Ministrinë e Drejtësisë organizoi në Tiranë një **Konferencë Rajonale për adresimin e VERLT**, ku autoriteteve përkatëse nga Ballkani Perëndimor iu dha mundësia të ndanin përvojat, sfidat, mësimet e marra dhe praktikatat e mira në programet e menaxhimit dhe rehabilitimit në burgje dhe Shërbimin e Provës. Për më tepër, gjatë Konferencës Rajonale, Prezenca prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e nxjerra nga Raporti i Vlerësimit të Nevojave të vendit dhe ofroi një mundësi për aktorët përkatës në Shqipëri për të diskutuar çështjet e ngritura me homologët e tyre nga rajoni.



Foto nga Konferenca Rajonale "Adresimi i VERLT dhe ndarja e praktikave më të mira të menaxhimit të burgjeve dhe Shërbimit të Provës dhe programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit", Tiranë, 1-2 nëntor 2018

Për qëllimin e dyfishtë të krijimit të lidhjeve më të forta dhe **mbështetjes së shkëmbimit rajonal të njohurive, Prezenca ka mbështetur një numër vizitash të palëve të interesuara shqiptare me homologët e tyre në rajon.** Për më tepër, Prezenca ka mbështetur aktivitete të ndryshme rajonale, si tryeza e mbyllur shqiptaro-jordaneze në kuadër të Takimeve Aqaba kundër terrorizmit, Konferenca Rajonale CVE e Ballkanit Perëndimor dhe Konferenca e 10-të ndërkombëtare për Drejtësinë Restauruese, në të cilën Prezenca paraqiti ide konkrete në adresimin e konflikteve dhe dhunës përmes praktikave restauruese.



Foto nga Simpoziumi Ndërkombëtar "Nga ndërmjetësimi penal në drejtësi restauruese", Universiteti i Deustos në Bilbao, Spanjë 5-6 qershor 2019

Prezenca mbështeti, gjithashtu, pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore shqiptare në Simpoziumin Ndërkombëtar "Nga ndërmjetësimi penal në drejtësi restauruese" të organizuar nga Forumi Evropian për Drejtësinë Restauruese, në Bilbao, Spanjë, në qershor 2019.

Rezultati IV

Komponenti i katërt i projektit iu kushtua **rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive të një audience të gjerë dhe të palëve të interesuara**, mbi P/CVERLT në burgje dhe në Shërbimin e Provës në Shqipëri, duke rritur respektimin e të drejtave të njeriut.

Prezenca në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës organizoi **gjashtë forume ndërgjegjëse me pjesëmarrjen e rreth 220 të rinjve nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës** dhe disa anëtarëve të stafit në Shërbimin e Provës, në zyrat vendore në Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë, Tiranë dhe Fier. Këto forume synuan rritjen e ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve për ekstremizmin e dhunshëm dhe shërbyen si një platformë për vlerësimin e nevojave dhe sfidave të të rinjve nën mbikëqyrje.



Foto nga forumet ndërgjegjëse me të rinj nën mbikëqyrje të Shërbimit të Provës, qershor-tetor 2019

Prezenca, në bashkëpunim me **zyrën e Avokatit të Popullit**, Qendrën Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Ministrinë e Drejtësisë, organizoi në Tiranë në dhjetor 2018, **konferencën me temë "Respektimi i të Drejtave të Njeriut në kuadër të P/CVE në institucionet e privimit të lirisë dhe Shërbimin e Provës"**. Kjo konferencë tërhoqi vëmendjen te roli kryesor që institucionet shtetërore dhe shoqëria civile luajnë në luftën kundër radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Konferenca gjithashtu theksoi se roli i Avokatit të Popullit në trajtimin e këtij fenomeni është po aq i rëndësishëm në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut.

Tri Leksione të Hapura u organizuan me pjesëmarrjen e rreth 200 studentëve të programit të masterit të iniciuar nga Prezenca "Administrimi i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë", në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Qendrën Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Këto leksione të hapura shërbyen për të rritur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit nga studentët mbi fenomenin VERLT dhe ndërhyrjet e bazuara në të drejtat e njeriut për trajtimin e çështjes. Leksionet u bënë pjesë e kontributit të Prezencës në kurrikulën e këtij masteri në Universitetin e Tiranës, duke përfshirë futjen e një moduli të ri për CVE bazuar në kornizën e OSBE-së për CVE dhe standardet në të mira ndërkombëtare. Përveç rritjes së ndërgjegjësimit, ky program rrit aftësitë e Universitetit për mësimdhënien mbi CVE-në, me fokus të veçantë në masat parandaluese.



Foto nga Konferenca "Respektimi i të Drejtave të Njeriut në kuadër të P/CVE në institucionet e privimit të lirisë dhe Shërbimin e Provës", Tiranë, dhjetor 2018

Në përgjithësi, projekti identifikoi kontekstin aktual, çështjet dhe mundësitë që Shqipëria të trajtojë fenomenin VERLT në burgje dhe Shërbimin e Provës në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Puna e bërë nga Prezenca rriti ndërgjegjësimin dhe ngriti kapacitetet e institucioneve penitenciare, duke ofruar studime të sakta dhe të dhëna kyçe, të cilat aktualisht mungojnë, ndërsa gjithashtu ndihmoi në hartimin e masave të përshtatshme dhe në përputhje me të drejtat e njeriut për të ndihmuar në adresimin e kësaj sfide. Puna u përqendrua, në mënyrë të veçantë, në ndërtimin e një baze për uljen e rrezikut, programet e shkëputjes dhe ri-integrimit dhe kthimitin e Luftëtarëve të Huaj të Terrorizmit (FTF) përmes komponentëve të ndërlidhur në fushën e burgjeve dhe Shërbimit të Provës.



Foto nga Leksionet e Hapura me studentët e masterit mbi VERLT dhe adresimin e tij në burgje dhe Shërbimin e Provës, Tiranë, korrik-dhjetor 2019

Ky projekt u mbështet financiarisht nga Qeveria e Austrisë, Qeveria e Suedisë, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Italisë.